



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA LIBRAZH D**

**RELACION TEKNIK**

**OBJEKTI: “PERMIRESIMI I BANESAVE EKZISTUESE, BASHKIA LIBRAZH D, VITI 2024”.**

**Te pergjithshme**



Bashkia e Librazhdit perbehet nga 7 njesi administrative : Njesia Librazhd, Qender, Hotolisht, Polis, Orenje, Lunik, Stebleve , me nje popullsi prej 43646 banore sipas Regjistrit te Gjendjes Civile . Ne zonat administrative kryesisht por edhe ne qytet banojne shume familje ne nevoje te cilat trajtohen me ndihme ekonomike dhe pjesa me e madhe e kane organizuar jetesen ne fshat , te vetpunuar ne bujqesi dhe blegtori.

**Projekti**

Projekti i permiresimit te banesave ekzistuese eshte nje programet qe aplikohet dhe qe u vjen ne ndihme shume familjeve ne bashkine Librazhd.

Qellimi i projektit eshte qe te permiresohen kushtet e jeteses per disa banore qe kane nevoje per ndihme. Nepermjet ketij projekti realizohen punime ndertimore me qellim rikonstruksion te objekteve ekzistuese. Per cdo banese pjese e ketij projekti jane bere verifikimet dhe matjet e duhura duke konstatuar dhe llojin e nderhyrjeve qe kane nevoje. Projekti parashikon nderhyrje ne cati, perforcim te strukturave te banesave, suvatime te brendshme dhe te jashtme, shtrese pllaka dysHEME, etj. Te gjitha punimet pasqyrohen ne projektin teknik te nderhyrjes dhe ne preventivin e punimeve.

**Perfituesit**

Numri i banesave qe jane te perfshira ne projekt eshte 43 banesa, te shperndara ne njesi administrative dhe ne qytet. Kushtet ne te cila ndodhen keto shtepi kane nevoj emergjente per nderhyrje ne to. Problematikat me te medha jane ne futjen e ujit mbrenda, cati te amortizuara, mure te care, tavane te rene, lageshtire e theksuar, tjegulla te amortizuara etj.



